



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 380/9 prot.

Tiranë, 5.10.2018

Lënda: Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 65, datë 13.9.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Valbona Bala

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për kompetencë: Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Për dijeni: Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

Depozituar pranë: Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, në datë 20.9.2018 është njoftuar vendimi nr. 65, datë 13.9.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim znj. Valbona Bala (Pajo), këshilltare në Gjykatën Kushtetuese.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 65, datë 13.9.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit znj. Valbona Bala (Pajo) ka ushtruar funksionin e këshilltares ligjore pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës Kushtetuese, prej datës ***.4.2008 deri më datë ***.4.2017, moment në të cilin dorëheqja e saj nga detyra (dorëzuar më 31.3.2017) është bërë efektive me anë të Urdhrit të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, nr.***, datë ***.4.2017, “Për lirim nga detyra dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës”.

2. Mbajmë në konsideratë se ndërkohë që subjekti ka paraqitur dorëheqjen, ligji nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, kishte hyrë në fuqi prej 8 muajve, pra në datë 11.8.2016¹, moment në të cilin sipas nenit 179/b, pika 4, paragrafi i parë² i Kushtetutës, znj. Bala, në detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, ka marrë cilësinë e subjektit që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar. Gjithashtu, referuar ligjit nr. 84/2016³, dalë në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, me qëllim përcaktimin e procedurave dhe kriteret e rivlerësimit, dorëheqja e subjektit në këtë rast nuk është dhënë në kushtet e nenit 56 të ligjit, pra paraqitja me shkrim pranë Presidentit të Republikës dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), me anë të shkresës nr.*** prot., datë ***.3.2018, i është drejtuar Institucionit të Presidentit të Republikës, ku i ka kërkuar informacion mbi emrat e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, *që vijnë nga sistemi i gjyqësor*, me qëllim që Komisioni t’i vlerësojë me përparësi këto kandidatura.

4. Institucioni i Presidentit të Republikës, me anë të shkresës nr. *** prot., datë ***.3.2018, i është përgjigjur Komisionit dhe i ka vënë në dispozicion listën e plotë (jo vetëm kandidatët nga sistemi gjyqësor) të aplikantëve që kanë paraqitur kërkesë për vendin vakant dhe vakancën e parakohshme gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur sipas dekretit nr.***, dhe atij nr.***, të datës ***.2.2018 të Presidentit të Republikës, ku ndër të tjera figuron edhe emri i subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala, cilësuar si këshilltare pranë ***.

5. Më datë ***.4.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Bala, i është drejtuar Komisionit dhe për dijeni ILDKPKI-së, DSIK-së dhe Inspektoratit të KLD-së, me anë të shkresës me lëndë *për përditësim të dhënash*, ku ndër të tjera pasi informon se ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2008 - 2017 dhe se ka depozituar rregullisht brenda afatit ligjor formularët e vetëdeklarimit pranë institucioneve ndihmëse të procesit të rivlerësimit (ILDKPKI, DSIK, Inspektoratit të KLD-së), shprehet se në datën 1 maj 2017 ka dhënë dorëheqjen vullnetarisht nga funksioni i këshilltares së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, duke vijuar veprimtarinë profesionale si këshilltare e nivelit të lartë pranë një projekti të ***, e për këtë arsye ka vënë në dispozicion e-mailin e saj privat, të disponueshëm për çdo nevojë komunikimi në vijim të procesit të rivlerësimit.

6. Më datë ***.5.2018, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur fillimin e hetimit administrativ sipas procedurave të rivlerësimit për subjektin znj. Bala, për të tria kriteret e vlerësimit.

7. Më datë ***.6.2018, Komisioni ka njoftuar subjektin, znj. Bala, për përbërjen e trupës gjyquese, si dhe i ka dërguar pyetësorin e parë për qëllim të procesit të rivlerësimit.

¹ Referuar Fletores Zyrtare (F. Z.) nr.138, datë 27 korrik 2016. Ligji ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në FZ.

² Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

³ Pas botimit në F. Z. nr.180, datë 23.9.2016, ligji hyri në fuqi më datë 8.10.2016. Në datë 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese, dhe afati i zbatimit të tij ecën për 17 ditë. Në datë 18.1.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit e njëkohësisht pezullimin e tij. Ky vendim është botuar në F. Z. në datë 19.1.2017. Nisur nga fakti i pezullimit dhe ecja e afatit, afati 3-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit sipas nenit 56 të tij, për dorëheqjen, ka mbaruar në datë 31.3.2017.

8. Më datë ***.6.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Bala, i drejtohet Komisionit⁴ me kërkesë për qartësimin e pozicionit të saj si subjekt në procesin e rivlerësimit, ku ndër të tjera parashtron se:

- i. Në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, unë ushtroja funksionin e Këshilltares ligjore, që në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 përfshihet në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio*. Në plotësim të detyrimeve kushtetuese e ligjore kam dorëzuar deri në 31 janar 2017 pranë ILDKPKI-së, DSIK-së dhe Inspektoratit të KLD-së të gjithë dokumentacionin e përcaktuar për rivlerësimin e pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale;
- ii. Në muajin shkurt 2018, pas shpalljes nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë i vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, kam shprehur interesin pranë të dyja institucioneve...;
- iii. Në muajin prill 2018⁵, Shkolla e Magjistraturës më ka njoftuar me e-mail për zhvillimin e testimit për efekt të rivlerësimit profesional. Në rregulloren e vënë në dispozicion parashikohej mundësia që ish-këshilltarët e GJK-së (apo ish-ndihmësit e Gjykatës së Lartë) të merrnin pjesë në testim dhe nëse kalonin kufirin prej 60% të pikëve në të dyja fazat e testimit fitonin të drejtën të vijonin karrierën si magjistratë... dhe nga provimi i zhvilluar në datat 7-8 maj, rezultati më pamundësoi përfshirjen në grupin që do të vijojë trajtimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe karrierën si magjistrate;
- iv. Në njoftimin e datës ***.5.2018, në faqen zyrtare të Komisionit, kam konstatuar se më 15 maj 2018 jam shortuar dhe kanë filluar procedurat e rivlerësimit për mua si subjekt rivlerësimi me dy cilësi, si kandidate në Gjykatën Kushtetuese dhe ish-këshilltare e Gjykatës Kushtetuese;
- v. Në datën ***.6.2018 kam marrë njoftim në adresën personale me subjekt: “Njoftim për përbërjen e trupës gjyquese dhe kërkim informacioni për pyetësorin bashkëngjitur”. Nga e-maili konstatova se e-maili është çuar fillimisht në adresën që disponoja si këshilltare në GJK;
- vi. Subjekti, pasi bën referim dhe trajtim të neneve 179/b- *ex officio*, vijon ... rivlerësimi lidhet me funksionin apo mbajtjen/ushtimin *de facto* të detyrës..., trajtimin të kategorisë së ish-këshilltarëve, të cilët i nënshtrohen procesit... me kërkesë dhe me plotësimin e kriterëve ligjore, referimit të pikës 6 dhe 7 të nenit 179/b të Kushtetutës, **ka kërkuar**;
- vii. ... në kushtet kur nuk ushtroj aktualisht një funksion, për shkak të të cilit duhet t'i nënshtrohem procesit të rivlerësimit *ex officio* (vendimi juaj sipas nenit 58/1/a/b/c), kur nuk kam kaluar pragun e kërkuar për t'u kualifikuar si kandidat potencial për magjistrat (vendimi juaj sipas nenit 58/2), marrë në konsideratë të drejtën kushtetuese për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vijimin e karrierës, si dhe kur nuk kam refuzuar kontrollin përmes dorëheqjes sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës, por përkundrazi kam shprehur vullnetin për të qëndruar në sistemin e drejtësisë, përmes aplikimit për pozicionin e Gjyqtarit në GJK... do ta vlerësoja shumë që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të qartësonte cilësinë me të cilën është duke vijuar procesin e rivlerësimit në rastin tim.

9. Në vijim të shkresës së sipërcituar, më datë ***.6.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Bala, i drejtohet sërish Komisionit⁶, për dijeni përfaqësuesit të ONM-së dhe Inspektoratit të KLD-së, ku ndër të tjera është shprehur se:

- i. “... paraqitja e dorëheqjes nga funksioni i këshilltares u bë për arsye të vijimit të karrierës profesionale pranë projektit të ***... Unë nuk kam paraqitur dorëheqje pranë

⁴ Protokolluar pranë KPK-së me nr.*** prot., datë ***.6.2018.

⁵ Kujtojmë se më datë 31 mars 2017 subjekti kishte paraqitur dorëheqjen pranë Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, efektive prej datës 30 prill 2017.

⁶ Protokolluar pranë KPK-së me nr.*** prot., datë ***.6.2018.

Presidentit të Republikës brenda afatit 3-mujor, por kam treguar dukshëm dhe me veprime aktive vullnetin tim për të qëndruar në sistemin e drejtësisë;

- ii. ... tërësia e veprimeve të mësipërme (aplikimi për GjK; testi pranë Sh. Magjistraturës) mund të konsiderohet si kërkesë për vijimin e procesit të rivlerësimit, megjithëse më lejoni të nënvizojë se, pavarësisht vullnetit tim si ish-këshilltare për të vijuar procesin e rivlerësimit, ligji e ka lidhur këtë rivlerësim ngushtësisht me plotësimin e kriterëve ligjore;
- iii. Për sa më sipër... gjykoj se procesi i rivlerësimit që KPK-ja është duke kryer në rastin tim nuk i takon për së paku fazës së rivlerësimit të subjekteve prioritare dhe më së shumti as subjekteve ex officio dhe as atyre vullnetare...;
- iv. Dua të nënvizojë fort faktin se ky komunikim nuk ka për qëllim refuzimin dhe as shmangien nga procesi i rivlerësimit...
- v. Ju bëj me dije se në respekt të detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor për rivlerësimin, po vijoj me përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke ju venë në dispozicion informacionin e kërkuar... do të vlerësoja të më vini në dispozicion brenda mundësive tuaja një përgjigje për rastin konkret.... E lë në çmuarjen e Komisionit nëse janë kushtet për vijimin ose jo të procesit të rivlerësimit.

10. Më datë ***.6.2018, Këshilli i Lartë i Drejtësisë⁷, pas kërkesës së Komisionit, i ka vënë në dispozicion këtij të fundit aktet përkatëse shtesë të siguruara nga Gjykata Kushtetuese, ku bashkëlidhur gjenden kërkesa e datës 31 mars 2017, për dorëheqjen e znj. Valbona (Pajo) Bala nga funksioni i këshilltares së Gjykatës Kushtetuese drejtuar kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe urdhrin e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, nr.***, datë ***.4.2017, “Për lirimin nga detyra dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës”.

11. Më datë ***.9.2018⁸, vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “b” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur opinionin e tij me shkrim lidhur me këtë çështje, ku pasi analizon situatën e subjektit, në përfundim shprehet se “... procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Valbona Bala Pajo, duhet të ndërpritet në zbatim të plotë të dispozitave të nenit G të aneksit të Kushtetutës”.

12. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të provave dhe fakteve të mbledhura, dëgjimit të arsyetimit ligjor dhe rekomandimit të relatores së çështjes⁹, mbështetur në nenin G të aneksit të Kushtetutës, ka vendosur:

- i. Të ndërpresë procesin e rivlerësimit kalimtar të znj. Valbona Bala (Pajo).
- ii. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁷ Protokolluar pranë KPK-së me nr. *** prot., datë ***.6.2018.

⁸ Protokolluar pranë KPK-së me nr.*** prot., datë ***.9.2018.

⁹ Bazuar në nenin 14, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, relatorja e çështjes, ndër të tjera, ka parashtruar para trupës, duke arsyetuar e propozuar... “se pavarësisht se dorëheqja e subjektit nuk është paraqitur pranë Presidentit të Republikës dhe botimit në faqen zyrtare të këtij institucioni, fakt i cili ka pamundësuar marrjen dijëni nga ana e KPK-së, dorëheqja nga funksioni i këshilltarit pranë GjK-së, e përjashton znj. Bala nga të qenit subjekt i rivlerësimit ex officio dhe duke qenë se dorëheqja është dhënë në datën 31 mars, pra brenda afatit 3-mujor parashikuar nga neni 56 i ligjit, procesi i rivlerësimit duhet të ndërpritet po sipas kësaj dispozite ligjore”. Ndërkohë vijon arsyetimin duke referuar nenin G të aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se “sipas kësaj dispozite, kuptohet qartë se pasoja e dorëheqjes nga funksioni i këshilltares ligjore në GjK nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Bala, është ndërprerja e procesit të rivlerësimit (pika 1 e nenit G) dhe ndalimi i emërimit të saj në një prej funksioneve të parashikuar nga pika 2 e nenit G, për një periudhë 15-vjeçare”. Pasi trajton kategorinë tjetër, atë të ish-këshilltarëve, gjyqtarëve, prokurorëve etj. (neni 179/b, pika 4, paragrafi 2), propozon që KPK-ja, bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin G të aneksit të Kushtetutës, të marrë vendim për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

13. Në vendimin përkatës, në pjesën arsyetuese, Komisioni konstaton se në përputhje me nenin 179/b, pika 4, fjalia e parë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese, janë subjekte të rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*. Për këtë arsye, znj. Valbona Bala është subjekt rivlerësimi në momentin që ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi. Znj. Valbona Bala ka dorëzuar brenda datës 31.1.2017, pranë ILDKPK-së, DSIK-së dhe KLD-së, dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

14. Neni G i aneksit të Kushtetutës parashikon se: (1) *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.* (2) *Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*

15. Sipas kësaj dispozite kuptohet qartë se pasoja e dorëheqjes nga funksioni si këshilltarë ligjorë në Gjykatën Kushtetuese nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Bala (brenda tre muajve që ligji kishte hyrë në fuqi) është ndërprerja e procesit të rivlerësimit (neni G, pika 1) dhe ndalimi i emërimit të saj në një prej funksioneve gjyqtar ose prokuror i çdo niveli etj., për një periudhë 15-vjeçare (neni G, pika 2).

16. Në përputhje me nenin 179/b, pika 4, fjalia e dytë, procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Pavarësisht se znj. Valbona Bala ka ushtruar funksionin e këshilltares në Gjykatën Kushtetuese, ajo nuk është subjekti rivlerësimi me kërkesë sipas kësaj dispozite, për arsyet si vijojnë:

16.1 Përveç faktit se nuk ka një kërkesë nga ana e saj për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit, ajo nuk mund t'i nënshtrohet këtij procesi në cilësinë e ish-këshilltares (për efekt të ligjit nr. 84/2016), për arsye se faktikisht ajo nuk e gëzon këtë status, pikërisht për shkak të dorëheqjes së parevokueshme që ka dhënë nga funksioni i Këshilltares së Gjykatës Kushtetuese, në kohën që ligji ishte në fuqi.

16.2 Në shkresën e saj drejtuar Komisionit, më datë ***.6.2018, ajo parashtron ndër të tjera se: *“Procesi i rivlerësimit që Komisioni është duke kryer ndaj saj, nuk i takon për së paku fazës së rivlerësimit të subjekteve prioritare, e më së shumti as subjekteve ex officio e as atyre vullnetare”*. Znj. Valbona Bala pranon se nuk është subjekt vullnetar vlerësimi sipas nenit 179/b të aneksit të Kushtetutës.

16.3 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vazhdimi i procesit të rivlerësimit me statusin e ish-këshilltares për subjektin e rivlerësimit Valbona Bala (Pajo) do të cenonte qëllimin e nenit G të aneksit të Kushtetutës, pasi të gjithë subjektet e rivlerësimit *ex officio*, pas dorëheqjes, do të kishin të drejtë të bëheshin “subjekte rivlerësimi vullnetar”, ndërkohë që paragrafi i dytë i këtij neni ndalon emërimin e tyre në ato funksione për një periudhë 15-vjeçare.

16.4 Në interpretim të dispozitave të mësipërme ligjore, trupi gjykues ka çmuar se subjekte vullnetarë sipas nenit 179/b, pika 4 të Kushtetutës, do të jenë vetëm ata të cilët kanë qenë “ish-gjyqtarë” ose “ish-këshilltarë ligjorë” në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, dhe që kanë punuar në këto pozicione pune të paktën për tre vjet. Si rrjedhim, znj. Valbona Bala nuk e gëzon këtë status.

III. Shkaqet e ankimit

17. Komisioneri Publik pas vlerësimit të rrethanave dhe fakteve të administruara nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit znj. Bala, në konsideratë të qëllimit të përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës dhe vendimit orientues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr.1/2018 (JR), çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk është i drejtë, pasi procesi i rivlerësimit për subjektin Valbona Bala Pajo duhet të ndërpritej vetëm në zbatim të plotë të nenit G të aneksit të Kushtetutës, përfshirë këtu ndalimin e parashikuar në pikën 2 të kësaj dispozite.

18. Komisioni, në raport me ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret duhej të argumentonte në mënyrë shteruese natyrën specifike të statusit që gëzon subjekti konkret i rivlerësimit, sa i përket administrimit të plotë të akteve dhe dokumentacionit që lidhet me shprehjen e qartë dhe pa ekuivok të vullnetit për dhënien e dorëheqjes, me qëllim saktësimin e efekteve ligjore shkak-pasojë për procesin e rivlerësimit. Nga arsyetimi i vendimit duket sikur Komisioni konfondon cilësimin ligjor të subjektit, duke arsyetuar nën regjimin e nenit 179/b, pika 4, paragrafi i dytë, *ish-këshilltarët*, kategori kjo e cila ka rregullim tërësisht të ndryshëm ligjor nga kategoria këshilltarë të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 179/b, pika 4, paragrafi i parë.

19. Cilësimin si subjekt i rivlerësimit për qëllim të nenit 179/b të Kushtetutës, znj. Bala e ka marrë prej momentit të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8417/1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe jo me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, siç arsyeton Komisioni. Ligji nr. 76/2016 ka hyrë në fuqi prej datës 11.8.2016, moment në të cilin znj. Bala ka qenë në detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 4, fjalia e parë, subjekti ka marrë cilësimin e subjektit të rivlerësimit dhe procesi ndaj saj ka filluar me dorëzimin pranë ILDKPKI-së, DSIK-së dhe KLD-së, të dokumentacionit të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

20. Momenti i hyrjes në fuqi i ndryshimeve kushtetuese merr rëndësi në këtë rast, pasi ky moment deçiziv përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjektit në raport me procesin e rivlerësimit, duke e konsideruar kështu subjekt të rivlerësimit kalimtar për shkak të detyrës (*ex officio*). Vlen të theksohet se ky status për qëllim të procesit të rivlerësimit mund të ndryshojë duke u *pushuar apo ndërprerë*, vetëm në dy raste si shkak i vullnetit të subjektit me anë dorëheqjes, (i) ai i parashikuar në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe (ii) nenin G të aneksit të Kushtetutës, ku qëllimi i të dyja dispozitave ka qenë që t’i japë mundësi subjekteve për t’u larguar me dëshirë, pa iu nënshtruar procesit të rivlerësimit. Por në rastin e nenit 56 të ligjit, subjekti përfiton edhe një pagesë kalimtare, mundësi të cilën nuk e përfitojnë ata të dorëhequr pas përfundimit të afatit 3-mujor, si në rastin e nenit G të aneksit të Kushtetutës. E përbashkëta e këtyre dispozitave është se parashikimi i pikës 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës zbatohet në të dyja rastet. Pra ndalimi kushtetues i së drejtës së emërimit në një nga funksionet e përcaktuar për 15 vitet në vazhdim i shtrin efektet edhe në rastin e dorëheqjes sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.

21. Duke ju rikthyer rastit në shqyrtim, referuar gjendjeve të akteve dhe arsyetimit të vendimit, është i paqartë shkak ligjor që ka shërbyer për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit për subjektin znj. Bala dhe arsyeja pse nuk është zbatuar aplikimi i plotë i nenit G të aneksit të Kushtetutës. Kështu, Komisioni, pasi referon nenin G, shprehet se “*kuptohet qartë se pasoja e dorëheqjes nga funksioni i këshilltares ligjore... nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Bala (brenda 3 muajve që ligji kishte hyrë në fuqi) është ndërprerja e procesit të rivlerësimit (neni G, pika 1) dhe ndalimi i emërimit të saj në një prej funksioneve gjyqtar ose prokuror i çdo niveli etj., për një periudhë 15-vjeçare (neni G, pika 2)*. Më pas, Komisioni vijon arsyetimin me kategorinë tjetër, ata ish-këshilltarë, parashikuar në nenin 179/b, pika 4, fjalia e dytë, duke konkluduar se: “*pavarësisht se znj. Bala ka ushtruar funksionin e këshilltares në GJK, ajo nuk është subjekt i rivlerësimit me kërkesë sipas kësaj*

dispozite... dhe përveç faktit se nuk ka një kërkesë nga ana e saj... ajo nuk mund t'i nënshtrohet këtij procesi në cilësinë e ish-këshilltares... për arsye se faktikisht ajo nuk e gëzon këtë status, pikërisht për shkak të dorëheqjes së parevokueshme që ka dhënë nga funksioni i Këshilltares së GJK-së, në kohën që ligji ishte në fuqi”.

22. Bazuar në këtë interpretim të paqartë, Komisioni pranon se efektet e nenit G duhen aplikuar në rastin konkret, por, duke qenë se znj. Bala ka dhënë dorëheqjen brenda 3 muajve, sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016, vazhdimi i procesit të rivlerësimit me statusin e ish-këshilltares për subjektin e rivlerësimit do të cenonte qëllimin e nenit G të aneksit të Kushtetutës, pasi të gjithë subjektet e rivlerësimit *ex officio*, pas dorëheqjes do të kishin të drejtë të bëheshin “subjekte rivlerësimi vullnetar”, ndërkohë që paragrafi i dytë i këtij neni ndalon emërimin e tyre në ato funksione për një periudhë 15-vjeçare.

23. Komisioneri Publik nënvizon se subjektet e parashikuara në nenin 179/b, pika 3 dhe 4, i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio* për shkak se me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të reja kushtetuese, ata janë gjendur në detyrë (*officio*), status ky i cili ndryshon duke u pushuar apo ndërprerë, vetëm në kushtet e përcaktuara në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe neni G i aneksit të Kushtetutës. Ndryshimi i detyrës së subjektit të rivlerësimit gjatë ecurisë së procesit për shkaqe dhe arsye të tjera, tej atyre të përcaktuara nga dispozitat e sipërcituara, nuk ndikon në ecurinë e procesit nga organi rivlerësues.

24. Për më tepër, arsyetimi i Komisionit nuk i përgjigjet provave të administruara për këtë qëllim, dhe vetë vullnetit të shprehur nga subjekti me anë të shkresave të datës 25 dhe 27 qershor 2018¹⁰, ku ndër të tjera subjekti shprehet se: *“nuk kam refuzuar kontrollin përmes dorëheqjes sipas nenit G të aneksit të Kushtetutës, por, përkundrazi, kam shprehur vullnetin për të qëndruar në sistemin e drejtësisë, përmes aplikimit për pozicionin e Gjyqtarit në GJK... do ta vlerësoja shumë që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të qartësonte cilësinë me të cilën është duke vijuar procesin e rivlerësimit në rastin tim, apo ...Unë nuk kam paraqitur dorëheqje pranë Presidentit të Republikës brenda afatit 3-mujor, por kam treguar dukshëm dhe me veprime aktive vullnetin tim për të qëndruar në sistemin e drejtësisë... dua të nënvizojë fort faktin se ky komunikim nuk ka për qëllim refuzimin dhe as shmangien nga procesi i rivlerësimit... E lë në çmuarjen e Komisionit nëse janë kushtet për vijimin ose jo të procesit të rivlerësimit”.*

25. Duke qenë përballë këtyre rrethanave dyzuese dhe jo të qarta në vetë vullnetin e shprehur nga subjekti në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe pasojat ligjore të dorëheqjes së saj, i takonte Komisionit që të identifikonte saktë shkakun ligjor mbi të cilin po ndërpriste procesin e rivlerësimit dhe në përputhje me orientimin e marrë nga vendimi nr. 1/2018 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në këto kushte vërejmë se në vendimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Bala, Komisioni, përveç se nuk ka caktuar në pjesën urdhëruese ndalimin e emërimit për periudhën 15-vjeçare, sipas pikës 2, të nenit G, të Kushtetutës, duket se nuk ka mbajtur parasysh edhe orientimet e dhëna nga Kolegji në këto drejtime:

- i* verifikimi i vullnetit të lirë dhe të pavesuar të subjektit të rivlerësimit për dorëheqje;
- ii* verifikimin e rrethanave konkrete nëse jemi para rastit përjashtimor kur nuk mbahet seancë dëgjimore me subjektin.

26. Detyra e Komisionit në këtë rast, për të verifikuar vullnetin e dorëheqjes së dhënë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Bala, ngjan se ka qenë e nevojshme referuar dhe dy korrespondencave të subjektit (datë 25 e 27 qershor), ku subjekti përjashton dorëheqjen e saj sipas rregullimit ligjor të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe në kushtet e nenit G të aneksit të Kushtetutës. Komisioni i gjendur në këtë situatë ligjore mund të vlerësonte

¹⁰ Protokolluar pranë KPK-së me nr.*** prot., datë ***.6.2018 dhe nr.*** prot., datë ***.6.2018.

orientimin e dhënë nga Kolegji, në paragrafët 54¹¹ dhe 55¹² të vendimit nr. 1/2018 (JR), dhe të arsyetonte nëse ishte para rrethanave të përjashtimit nga e drejta për t'u dëgjuar apo duhej të zhvillonte seancë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit.

27. Në çdo rast, nisur nga roli që i njihet Komisionerit Publik nga Kushtetuta dhe ligji gjatë procesit të rivlerësimit, si përfaqësues i interesit publik, në vështrim të nenit 66/2, të ligjit nr. 84/2016, ne çmojmë se Komisioni, në dhënien e vendimit nr. 65/2018, duhet të kishte zbatuar domosdoshmërisht orientimin e Kolegjit, dhënë me anë të vendimit nr. 1/2018(JR), paragrafi 97, referuar edhe paragrafëve 63¹³, 70¹⁴, 71¹⁵, 72¹⁶, 79¹⁷, 93, 95 dhe 96.

IV. Kërkimi i ankimit

28. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

29. Duke gjetur me vend të nënvizojë se në zbatim të orientimit të dhënë nga ana e Kolegjit me vendimin nr. 1/2018 (JR), ruajtja e një standardi interpretimi dhe zbatimi të legjislacionit në raste të ngjashme është e nevojshme të garantohet;

30. Në kushtet kur vetë Komisioni më parë në kohë nga marrja e vendimit konkret nr. 65/2018, në dy raste të tjera të dhënies së dorëheqjes, vendimi nr. 28/2018 dhe nr. 38/2018, por edhe më pas në kohë nga marrja e vendimit konkret nr. 66/2018, në një rast tjetër të dhënies së dorëheqjes, vendimi nr. 66/2018, ka parashikuar në pjesën urdhëruese të vendimit dhe paragrafin 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës;

31. Referuar nenit F dhe G të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, vendimi nr.1/2018 JR, datë 11.6.2018;

32. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

¹¹ ...E drejta për t'u dëgjuar publikisht përfshin në vetvete të drejtën për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, përveç se kur ka rrethana përjashtimore. Si raste përjashtimore, Kolegji i Apelimit vlerëson edhe rastet e dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit nga procesi i rivlerësimit kalimtar, duke respektuar parimin e transparencës në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt, të sanksionuar nga neni 4, pika 2, e aneksit të Kushtetutës dhe neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Duke iu referuar nenit 4, pika 6, e ligjit nr. 84/2016, i cili referon Kodin e Procedurave Administrative, neni 89, i cili përcakton rastet e mbylljes së procedurës administrative pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar.

¹² ...paraqitja sipas ligjit e aktit të dorëheqjes i jep fund procedurës administrative të rivlerësimit, duke mos lejuar kryerjen e veprimeve procedurale të mëtejshme dhe si e tillë bën pjesë të rastet përjashtimore, në kushtet kur edhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është dhënë në dorëheqjen e paraqitur...

¹³ ...Shkak kushtetues për moskalimin me sukses të procesit të rivlerësimit përbën edhe instituti i dorëheqjes, i sanksionuar nga neni G, me titull: "Dorëheqja" ...Dorëheqja në vetvete e trajtuar posaçërisht nga Kushtetuta, nuk është shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sikurse nuk përbën shkak për konfirmimin në detyrë dhe, si e tillë, Kushtetuta e ka shoqëruar pandashmërisht edhe me përcaktim negativ të drejtash, siç është ndalimi i shtrimit të profesionit (funksionit) sipas pikës 2, të nenit G të Kushtetutës.

¹⁴ ...Kolegji i Apelimit çmon se në pjesën urdhëruese të vendimit duhet të përfshihet edhe parashikimi i paragrafit 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës, i cili sanksionon ndalimin për emërim, që duhet të aplikohet në rastin kur subjektet e rivlerësimit dorëhiqen nga detyra dhe procesi i rivlerësimit ndaj tyre ndërpritet.

¹⁵ ...parashikimi i përmendur në pjesën arsytuese të vendimit të Komisionit, në vlerësimin e Kolegjit të Apelimit duhet të përfshihet në pjesën urdhëruese të tij, pikërisht për zbatimin e drejtpërdrejtë të normës kushtetuese.

¹⁶ ...një vendimmarrje e pajisur me këto elementë heq çdo mundësi për keqinterpretime apo abuzime me të drejtën, apo ndalimin e subjektit të rivlerësimit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për periudhën 15-vjeçare dhe i jep një zgjidhje përfundimtare dhe të plotë çdo pretendimi, qoftë të subjektit të rivlerësimit në të nesërmen, si edhe garanton mbrojtjen e interesit të publikut të sanksionuar në Kushtetutë, për të mos lejuar kthimin e kësaj kategorie subjektesh në sistemin e drejtësisë për periudhën e përcaktuar në aneksin e Kushtetutës.

¹⁷ ...Në kuptimin material, ushtrimi i dorëheqjes nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit përbën shkak ligjor për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, por me kufizimin për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. E thënë ndryshe, ushtrimi i dorëheqjes nga detyra shoqërohet edhe me kufizim të drejtash, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

- Ndryshimin e vendimit nr. 65, datë 13.9.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA